

VENDIM
Nr. 636, datë 26.10.2018

PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE, TË MËNYRËS SË SHKËMBIMIT E TË PËRPUNIMIT TË INFORMACIONIT DHE TË TË DHËNAVE STATISTIKORE, TË KËRKUARA NGA AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS, PRANË STRUKTURAVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR E VENDOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton llojet, mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor.

2. Në kuptim të këtij vendimi, struktura shtetërore përgjegjëse janë të gjitha institucionet në nivel vendor e qendror, si dhe INSTAT-i, që kanë detyrimin të dërgojnë çdo vit pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës informacionin dhe të dhënat statistikore për treguesit e përcaktuar në këtë vendim.

3. Informacioni dhe të dhënat statistikore, të përcaktuara në këtë vendim, do të përdoren me qëllim:

a) Monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në kuadër të zbatimit të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe dokumenteve strategjike me fokus fëmijët;

b) Hartimin e politikave, të strategjive, programeve e masave konkrete në fushën e promovimit, të mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve.

4. Informacioni dhe të dhënat statistikore përfshijnë:

a) Të dhëna numerike për treguesit e përcaktuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Informacion shoqëruar, përshkrues, sipas kërkesave të shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, lidhur me treguesit e përcaktuar në këtë vendim.

5. Brenda 3-mujorit të parë të çdo viti, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kërkon informacionin dhe të dhënat statistikore vjetore për vitin paraardhës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor, sipas shtojcave të këtij vendimi. Agjencia publikon informacionin dhe të dhënat statistikore çdo vit, në faqen e saj zyrtare.

6. Njësitë për mbrojtjen e fëmijës raportojnë periodikisht, çdo 3 muaj, dhe në fund të vitit me një raport vjetor pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të dhënat statistikore dhe narrative që kanë mbledhur për fëmijët, të cilët jetojnë brenda dhe jashtë vendit, që janë në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe të njësive administrative përkatëse brenda vendit, dhe për fëmijët me shtetësi shqiptare, që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i përpunon këto të dhëna, duke realizuar strukturimin e të dhënave në nivel kombëtar.

7. Shkëmbimi i informacionit dhe i të dhënave statistikore nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor, si dhe publikimi i informacionit, sipas pikës 5 të këtij vendimi, bëhen në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantimin e konfidencialitetit.

8. Vendimi nr. 267, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

10. Ngarkohen strukturat përgjegjëse, në nivel qendror e vendor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E TREGUESVE

Nr.	Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave
1	Numri dhe përqindja e fëmijëve, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër, përqindje	INSTAT
2	Numri dhe përqindja e martesave deri 18 vjeç, sipas: - Gjinisë; - Moshës.	Numër, përqindje	INSTAT/Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)
3	Numri dhe përqindja e vajzave deri 18 vjeç që kanë lindur/regjistruar fëmijë, sipas moshës.	Numër, përqindje	INSTAT/DPGJC
4	Përqindja/numri i fëmijëve që jetojnë në nivel varfërie relative, disagregimi, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Numrit të fëmijëve në familje; - Ndarjes gjeografike.	Përqindje/numër	INSTAT/Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri
5	Numri i fëmijëve që jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës (0–18 vjeç); - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror (DPSHSSH)/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
6	Numri i fëmijëve që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshave; - Regjistrimi në sistemin parashkollor dhe në sistemin e arsimit bazë; - Qarqeve.	Numër	DPSHSSH/MSHMS
7	Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale (në fund të vitit), sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës (0–6 vjeç, 6–18 vjeç); - Llojit të shërbimit; - Sektorit të shërbimit (privat/publik/jopublik); - Qarqeve	Numër	DPSHSSH
8	Numri i fëmijëve në familje kujdestare në fund të vitit raportuar nga Shërbimi Social Shtetëror, sipas: - Statusit të aftësisë së kufizuar.	Numër	DPSHSSH
9	Numri i fëmijëve të shpallur “të braktisur” me vendim gjykatë.	Numër	Ministria e Drejtësisë (MD)

10	Numri i fëmijëve të birësuar gjatë vitit, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Aftësisë së kufizuar/probleme shëndetësore; - Brenda apo jashtë vendit; - Strukturës së familjes; - Qarqeve	Numër	Komiteti i Birësimit/MD
11	Niveli i vdekshmërisë neonatale (deri ditën e 27-të të jetës) për 1000 lindje të gjalla, sipas gjinisë.	Numër për një mijë	INSTAT
12	Vdekshmëria foshnjore (vdekjet e fëmijëve nën moshën 1 vjeç/1000 lindje gjallë), sipas gjinisë.	Numër për një mijë	INSTAT
13	Numri i vdekjeve të fëmijëve deri 1 vjeç, sipas shkakut të vdekjes.	Numër	MSHMS
14	Niveli i vdekshmërisë nën 5 vjeç për 1000 lindje të gjalla, sipas gjinisë.	Numër për një mijë	INSTAT
15	Niveli i vdekshmërisë amtare në 100,000 lindje të gjalla, sipas grup-moshës.	Numër për njëqind mijë	INSTAT/MSHMS
16	Përqindja e lindjeve të asistuara nga staf profesional.	Përqindje	MSHMS
17	Numri dhe përqindja e fëmijëve të lindur nën peshë sipas gjinisë.	Numër dhe përqindje	MSHMS
18	Incidenca e sëmundjeve të fëmijët, sipas: - Sëmundjeve; - Gjinisë - Grup-moshës.	Numër	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
19	Numri dhe përqindja e grave shtatzëna, diagnostikuar me HIV-pozitiv gjatë vitit që përdorin terapi antiretrovirale.	Numër dhe përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
20	Numri dhe përqindja e fëmijëve HIV-pozitiv që përdorin TAR (terapi antiretrovirale), sipas: - Grup-moshës; - Gjinisë.	Numër dhe përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
21	Përqindja e fëmijëve target që vaksinohen siç rekomandohet në kalendarin kombëtar të vaksinimit deri në moshën 1 vjeç, sipas vaksinave përkatëse.	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
22	Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç, nën peshë, sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
23	Përqindja e fëmijëve që ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri deri 6 muaj, sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
24	Përqindja e foshnjave (6 –24 muaj) që ushqehen me gjë edhe pas muajit 6, sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS

25	Përçindja e fëmijëve nën 5 vjeç me rritje të prapambetur për moshën, sipas: - Kategorive të prapambetjes; - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përçindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
26	Përçindja e fëmijëve nën 5 vjeç mbipeshë, sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përçindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
27	Numri i vetëvrasjeve të fëmijëve, të regjistruar nga policia, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
28	Numri i tentativave për vetëvrasje të fëmijëve të regjistruar nga policia, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
29	Numri i fëmijëve viktime të trafikimit gjatë vitit, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Kategorisë së regjistrimit të rastit (intervista formale/fillestare); - Qarqeve.	Numër	Ministria e Brendshme (MB)
30	Numri i fëmijëve viktime të mundshme trafikimi, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Kategorisë së regjistrimit të rastit (intervista formale/fillestare); - Qarqeve.	Numër	MB
31	Numri i fëmijëve refugjatë, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Vendit të origjinës; - Llojit të mbrojtjes; - Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar).	Numër	MB
32	Numri i fëmijëve që kanë kërkuar azil në Shqipëri, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Vendit të origjinës; - Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar).	Numër	MB

33	<p>Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar/të mbështetur nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshave; - Shtetësisë; - Aftësisë së kufizuar; - Llojit të rastit të menaxhuar; - Statusit të menaxhimit të rastit; - Nivelit të rrezikut të rastit; - Bashkive. 	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve - Bashkitë
34	<p>Numri i fëmijëve për të cilët është marrë masë mbrojtjeje, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojit të masës; - Statusit të aprovimit të masës. 	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve - Bashkitë
35	<p>Numri i fëmijëve që kanë raportuar një formë dhune, të regjistruar nga institucionet arsimore, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Nivelit arsimor; - Sektorit (privat/publik); - Llojit të dhunës së raportuar; - Dhunuesit të raportuar (mësuesit/moshatarët); - Aftësisë së kufizuar; - Ndarjes gjeografike. 	Numër	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)
36	<p>Numri i fëmijëve, viktimë të dhunës, të regjistruar nga institucionet shëndetësore sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Llojit të dhunës; - Ndarjes gjeografike. 	Numër	MSHMS
37	<p>Numri fëmijëve viktimë të veprave penale regjistruar nga policia, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Veprës penale; - Përfunduar në vdekje; - Ndarjes gjeografike. 	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
38	<p>Numri fëmijëve autorë të dyshuar të veprës penale regjistruar nga policia, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Veprës penale; - Ndarjes gjeografike. 	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
39	<p>Numri i fëmijëve (14–17 vjeç) në paraburgim, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës/ave penale; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim (po/jo); - Statusi i recidivimit (po/jo); - Kategoritë e masave alternative të marra; - Aftësisë së kufizuar (po/jo); - Ndarjes gjeografike. 	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

40	<p>Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) në burg, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës/ave penale; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim (po/jo); - Statusi i recidivismit (po/jo); - Aftësisë së kufizuar (po/jo); - Ndarjes gjeografike. 	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
41	<p>Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të trajtuar nga shërbimi i provës, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës penale; - Kategorive të masave të marra; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim; - Statusi menaxhimit të rastit (ri, mbartur/ proces, mbyllur). 	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
42	<p>Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të pandehur nën hetim të raportuar nga prokuroria, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Shtetësisë; - Veprës penale; - Kategorive të vendimeve të marra; - Masave të sigurisë së marra. 	Numër	Prokuroria e Përgjithshme
43	<p>Numri i fëmijëve viktime të veprave penale të raportuar nga prokuroria, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Shtetësisë; - Kategorive të dëmit (plagosje e lehtë/rëndë/vdekje); - Veprës penale. 	Numër	Prokuroria e Përgjithshme
44	<p>Numri i fëmijëve autorë të dyshuar të veprave penale të trajtuar në gjykatë, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Procedimeve penale; - Kategorive të vendimeve të marra. 	Numër	MD
45	<p>Numri i fëmijëve viktime të veprave penale të trajtuara në gjykatë, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Veprës penale; 	Numër	MD
46	<p>Numri i fëmijëve të trajtuar me urdhër mbrojtjeje në gjykatë, si viktime të dhunës në familje, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Kategorisë së urdhrit të mbrojtjes (urdhër mbrojtjeje/urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje). 	Numër	MD

47	<p>Numri i fëmijëve që kanë përfituar ndihmë ligjore falas, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Aftësisë së kufizuar; - Kategorisë së rastit (penale, civile, familjare, administrative). 	Numër	MD
48	<p>Numri i ankesave të vlefshme për fëmijët të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkakut të diskriminimit; - Kategorisë së rastit (nga fëmija/ët, në emër të fëmijës/ve, nga Komisioneri); - Statusi i menaxhimit të rastit (i ri/proces/ mbyllur sipas kategorive); - Fusha ku pretendohet diskriminimi (punësim, arsim, të mira dhe shërbime). 	Numër	Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi
49	<p>Numri i ankesave të vlefshme për fëmijët të trajtuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategorisë së rastit (nga fëmija/ët, në emër të fëmijës/ve, nga Komisioneri); - Statusi i menaxhimit të rastit (i ri/proces/ mbyllur sipas kategorive). 	Numër	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
50	<p>Numri i ankesave, kërkesave, njoftimeve dhe rasteve me iniciativë, të trajtuara nga Avokati i Popullit me objekt të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ankesa/kërkesa nga vetë fëmijët; Ankesa/kërkesa në emër të fëmijëve; Raste me iniciativë të trajtuara dhe inspektive; - Statusi i trajtimit të rastit (i ri/në proces/i mbyllur sipas kategorive). 	Numër	Avokati i Popullit
51	<p>Numri i fëmijëve (16–18 vjeç) të punësuar që kanë pësuar aksidente në punë sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Industrisë; - Llojit të punës që punonin. 	Numër	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
52	<p>Numri i fëmijëve punëmarrës raportuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Nivelit arsimor; - Llojit të aktivitetit të përfshirë. 		Ministria e Financave dhe Ekonomisë
53	<p>Numri i fëmijëve 0–3 vjeç që shkojnë në çerdhe, sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinisë; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Sektor publik/privat; - Bashkive. 	Numër	Bashkitë

54	Përqindja e fëmijëve 3-6 vjeç të regjistruar në kopsht, në krahasim me numrin total të fëmijëve 3-6 vjeç, sipas: - Gjinisë; - Moshës.	Përqindje	INSTAT/MASR
55	Përqindja e fëmijëve që janë regjistruar në klasën e parë në krahasim me numrin total të fëmijëve 6 vjeç sipas gjinisë.	Përqindje	INSTAT/MASR/NJËSITË ARSIMORE VENDORE
56	GER dhe NER, sipas ciklit të studimit/të arsimit dhe gjinisë (indeksi i barazisë gjinore).	Përqindje	INSTAT/MASR
57	Përqindja e braktisjes shkollore, sipas: - Gjinisë; - Nivelit arsimor. - Qarqeve; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare.	Përqindje	MASR/NJËSITË ARSIMORE VENDORE
58	Përqindja e nxënësve përsëritës, sipas nivelit: - Nivelit arsimor; - Gjinisë; - Aftësisë së kufizuar; - Qarqeve; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare.	Përqindje	MASR/NJËSITË ARSIMORE VENDORE

SHTOJCA 2
INFORMACIONI SHOQËRUES MBI TREGUESIT

Përshkrimi i treguesit	Treguesi	
	Përshkrimi i treguesit dhe i variablave	
Metodologjia	Institucioni/et përgjegjëse (mbledhje, përpunim, raportim)	
	Sistemi i mbledhjes së informacionit	
	Përlogaritja (përshkrim)	
Informacioni	Mbulimi kohor	

	Komente (përfshirë kufizimet, interpretimet)	
--	--	--